



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**PËR FUNKSIONIMIN E SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE TË
THEMELUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA SHOQËRITË
ADMINISTRUESE TË FONDEVE DHE DEPOZITARËT**

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 2, datë 27.01.2021

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kërkesat për veprimtarinë e sipërmarrjeve të investimeve kolektive që duhet të zbatohen nga shoqëritë administruese të фондеве dhe depozitarët e licencuar, si dhe nga subjektet të cilave shoqëritë administruese të фондеве dhe depozitarët i kanë deleguar aktivitetet përgjegjëse. Kjo rregullore përcakton gjithashtu kërkesat për kategorizimin e klientëve dhe trajtimin e klientëve nga shoqëritë administruese të фондеве dhe agjentët e tyre të shitjes.

**Neni 2
Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore përcakton kërkesat që zbatohen nga:

- a) Shoqëritë administruese të фондеве të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe çdo subjekt në të cilin janë deleguar aktivitetet, si dhe nga agjentët e shitjes të shoqërisë administruese të фондеве;
- b) Depozitari i sipërmarrjes të investimeve kolektive dhe çdo subjekt në të cilin janë deleguar aktivitetet.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo rregullore miratohet në bazë dhe në përputhje me nenet 24, 25, 32, 43, 44, 45, 104, Seksioni 3, 4 dhe 5 i Kreut V, nenit 137 pika 5 e nenit 195 të Ligjit nr.56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe seksioni 4 i Kreut IV të Ligjit nr.62/2020 “Për tregjet e kapitalit”.

Neni 4

Përkufizimet

1. Të gjitha përkufizimet e kësaj rregulloreje janë të njëjta me ato të Ligjit për sipërmarrjet e investimeve kolektive të referuar në këtë rregullore si "Ligji", si edhe të ligjit “Për tregjet e kapitalit”.
2. Transaksion “*Arms Length*” - transaksioni ku blerësi dhe shitësi i instrumentit financiar vepron në mënyrë të pavarur dhe në interesin më të mirë vetjak, ashtu siç do kishin vepruar nëse do të bënin transaksion me një palë tjetër jo të lidhur, të kryer në përputhje me kushtet normale të tregut, ku nuk ka asnjë favorizim të padrejtë të fituar nga njëra palë në përfitim të palës tjetër.
3. “*Ex-divident*” është një veprim korporativ si dividendi, i cili ka një datë të caktuar (ex) dhe mbajtësit e aksioneve të blera para kësaj date kanë të drejtën të marrin dividendin e ardhshëm, ndërsa mbajtësit e aksioneve të blera në atë datë ose pas saj nuk e kanë këtë të drejtë.

KREU II

TRANSAKSIONET QË KRYHEN NGA SHOQËRIA ADMINISTRUESE E FONDEVE PËR SIPËRMARRJEN E INVESTIMEVE KOLEKTIVE OSE NËNFONDIN

SEKSIONI 1

PËRKUFIZIMI DHE PRAKTIKA E EKZEKUTIMIT MË TË MIRË

Neni 5

Detyrimi për të vepruar në interesin më të mirë të sipërmarrjes apo nën-fondit

1. Shoqëria administruese e fondeve gjatë ekzekutimit të vendimeve për tregtimin e instrumenteve financiare në emër të sipërmarrjes ose të nën-fondit, duhet të veprojë në interesin më të mirë të secilës sipërmarrje ose nën-fondi që manaxhon.

2. Shoqëria administruese e fondeve gjatë ekzekutimit të vendimeve për tregtimin e instrumenteve financiarë, duhet të marrë të gjitha hapat e mjaftueshëm, për të marrë rezultatin më të mirë të mundshëm për secilën sipërmarrje ose nën-fond që manaxhon, duke marrë parasysh:
 - a) Çmimin;
 - b) Kostot;
 - c) Shpejtësinë;
 - d) Mundësinë e ekzekutimit;
 - e) Mundësinë e shlyerjes;
 - f) Madhësinë dhe natyrën e urdhrit; dhe
 - g) Çdo konsideratë tjetër që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit për tregtim;
Këtej e tutje referuar si 'faktorë ekzekutimi'.

Neni 6

Ekzekutimi më i mirë

1. Kur shoqëria administruese e fondeve tregon instrumenta financiare për llogari të një sipërmarrje ose nënfondi që menaxhon, ajo duhet të garantojë ekzekutimin më të mirë.
2. Shoqëria administruese e fondeve duhet të marrë të gjitha hapat e mjaftueshëm, gjatë ekzekutimit të urdhrave, për të arritur rezultatet më të mira të mundshme për investitorët/klientët e saj duke marrë parasysh rëndësinë relative të faktorëve të ekzekutimit sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 8 të kësaj rregulloreje.
3. Autoriteti e konsideron ekzekutimin më të mirë si të përmbushur nëse shoqëria administruese e fondeve duke vepruar për llogari të sipërmarrjes ose nën-fondit, sigurohet që urdhri është ekzekutuar me çmimin më të mirë në treg ose tregje në atë moment duke mbajtur në konsideratë madhësinë e urdhrit, palët dhe vendet e ekzekutimit të urdhrit.
4. Shoqëria administruese e fondeve duhet të krijojë dhe të zbatojë masa efektive si dhe të marrë të gjitha hapat e mjaftueshëm për të përmbushur detyrimin e saj për të arritur rezultatet më të mira të mundshme për sipërmarrjet dhe nën-fondet nën administrimin e saj.

Neni 7

Bashkimi dhe shpërndarja e drejtë

1. Nëse urdhrat për transaksione të shoqërisë administruese të fondeve bashkohen me ato të disa sipërmarrjeve ose nënfondeve, shoqëria administruese e fondeve duhet:
 - a) T'i shpërndajë instrumentet financiare në mënyrë të drejtë ndërmjet sipërmarrjeve ose nënfondeve, urdhrat e të cilëve janë bashkuar, në përpjesëtim me vlerën e secilit urdhër;

- b) Nëse si rezultat i bashkimit, totali i urdhrave të ekzekutuar nuk korrespondon me totalin e urdhrave të kërkuar, shuma e instrumenteve financiare të blerë ose të shitur duhet të shpërndahen në mënyrë proporcionale të çdo sipërmarrje ose nën-fond të bashkuar në përpjesëtim me vlerën e urdhrin të kërkuar të secilit klient;
 - c) Të mbartë pjesën e paekzekutuar të urdhërit të bashkuar në ditën tjetër kur tregtimet janë të mundshme dhe pastaj të aplikohet parimi i përcaktuar në shkronjën a), të kësaj pike.
2. Shoqëria administruese e fondeve nuk duhet të bashkojë një urdhër për sipërmarrjen ose nënfondin nën administrim me urdhrat për vetë shoqërinë administruese të fondeve, përveç rastit nëse një bashkim i tillë kryhet në përputhje me rregulloret e nxjerra nga Autoriteti ose tregu i rregulluar.

Neni 8

Faktorët në vendosjen e ekzekutimit më të mirë

1. Gjatë ekzekutimit të urdhrave për tregtim, shoqëria administruese e fondeve duhet të marrë parasysh kriteret e mëposhtme në përcaktimin e rëndësisë relative të faktorëve të ekzekutimit:
- a) Objektivat, politikën e investimeve dhe risqet specifike të sipërmarrjes ose nënfondit;
 - b) Karakteristikat e urdhrin për tregtim të instrumentit financiar që është subjekt i atij urdhri;
 - c) Karakteristikat e platformave të ekzekutimit ku do të drejtohet urdhri.
2. Shoqëria administruese e fondeve përmbush detyrimin e saj, sipas këtij neni, për marrjen e të gjitha hapave të mjaftueshme duke dokumentuar arritjen e për të arritur rezultatin më të mirë të mundshëm për një sipërmarrje ose nën-fond duke e ekzekutuar urdhrin në zbatim të një vendimi specifik si mënyrën më të mirë për të ekzekutuar urdhrin.
3. Shpejtësia, mundësia e ekzekutimit dhe shlyerjes, madhësia dhe natyra e urdhrin, marzhi i tregut (*spread*) dhe çdo kosto tjetër e fshehur e transaksionit, mund të kenë përparësi mbi çmimin dhe koston e atij momenti, vetëm nëse ato japin rezultatin më të mirë të mundshëm në lidhje me sipërmarrjen.

Neni 9

Dokumentimi i politikave më të mira të ekzekutimit të urdhrave

1. Politika e shoqërisë administruese të fondeve për ekzekutimin e urdhrave duhet të dokumentohet dhe duhet të përcaktojë rëndësinë relative të secilit prej faktorëve të ekzekutimit ose duhet të krijojë një proces sipas të cilit shoqëria administruese e fondeve do të përcaktojë rëndësinë relative të faktorëve të ekzekutimit. Rëndësia relative që shoqëria administruese e fondeve u jep këtyre faktorëve të ekzekutimit duhet

të bëhet në mënyrë të tillë që të marrë rezultatin më të mirë të mundshëm në ekzekutimin e urdhrave të sipërmarrjes ose të nënfondeve.

2. Për qëllime të kryerjes së ekzekutimit më të mirë, kur ekziston më shumë se një vend tregtimi për të ekzekutuar një urdhër për një instrument financiar, duhet të merren parasysh komisionet dhe kostot e vetë shoqërisë administruese të fondeve që i ngarkohen sipërmarrjes për ekzekutimin e urdhrat në secilën prej tregjeve apo platformave ku ekzekutohet urdhri, me qëllim vlerësimin dhe krahasimin e rezultateve më të mira të mundshme.
3. Çmimi ka një rëndësi të lartë relative në marrjen e rezultatit më të mirë të mundshëm për një sipërmarrje ose nënfond. Megjithatë, në disa rrethana, për disa urdhra, për disa instrumente financiare ose tregje, politika e përshtatshme e ekzekutimit të urdhrave mund të përcaktojë faktorë të tjerë të ekzekutimit që janë më të rëndësishëm sesa çmimi në marrjen e rezultatit më të mirë të ekzekutimit.
4. Shoqëria administruese e fondeve duhet të jetë në gjendje të vërtetojë se i transmeton dhe ekzekuton urdhrat në përputhje me politikën më të mirë të ekzekutimit.

Neni 10

Informimi i politikave më të mira të ekzekutimit

1. Shoqëria administruese e fondeve krijon dhe zbaton një politikë të ekzekutimit të urdhrave që të marrë rezultatin më të mirë të mundshëm në ekzekutimin e urdhrave për tregtim dhe duhet t'ia komunikojë këtë politikë si Autoritetit ashtu edhe investitorëve.
2. Ky informacion duhet të shpjegojë qartë se si do të ekzekutohen urdhrat për sipërmarrjen nga shoqëria administruese e fondeve, duke përfshirë:
 - a) Një listë të tregjeve apo platformave të ekzekutimit në të cilat shoqëria administruese e fondeve ka besueshmëri në përmbushjen e detyrimit të saj të marrjes të të gjitha hapave të arsyeshëm për të arritur në mënyrë të qëndrueshme rezultatin më të mirë të mundshëm për ekzekutimin e urdhrave për sipërmarrjen ose nënfondin dhe duke specifikuar se cilat platforma ekzekutimi përdoren;
 - b) Një listë të faktorëve të përdorur për të zgjedhur tregun apo platformën e ekzekutimit, përfshirë faktorët cilësorë, siç janë klerimi dhe shlyerja, veprimet e planifikuara ose edhe ndonjë faktor tjetër të rëndësishëm, si dhe rëndësinë relative të secilit faktor;
 - c) Informacionin rreth faktorëve të përdorur për të zgjedhur tregun apo platformën e ekzekutimit, i cili duhet të jetë në përputhje me kontrollet e përdorura nga shoqëria administruese e fondeve;
 - d) Faktorët e ekzekutimit të çmimit si kosto, shpejtësia, mundësia e ekzekutimit dhe çdo faktor tjetër relevant që konsiderohen si pjesë e të gjitha hapave të mjaftueshëm për të arritur rezultatin më të mirë të mundshëm për sipërmarrjen;

- e) Aty ku është e aplikueshme, informacionin se shoqëria administruese e fondeve ekzekuton urdhrat jashtë një platforme tregtimi, pasojat, për shembull riskun e palës tjetër që rrjedh nga ekzekutimi jashtë platformës së tregtimit dhe informacion shtesë për pasojat e këtij mjeti të ekzekutimit me kërkesë të investitorit.
3. Kur politika e ekzekutimit të urdhrave parashikon mundësinë që urdhrat mund të ekzekutohen jashtë tregut të rregulluar ose platformave shumëpalëshe të tregtimit (PSHT), shoqëria administruese e fondeve duhet t'i informojë investitorët në lidhje me këtë mundësi përmes publikimit të kësaj politike në faqen e internetit të shoqërisë.
4. Shoqëria administruese e fondeve shqyrton politikën e ekzekutimit të urdhrave sa herë që ndodh një ndryshim thelbësor që ndikon në aftësinë e shoqërisë administruese të fondeve të marrë rezultatin më të mirë të mundshëm për sipërmarrjet ose nënfondet nën administrimin e saj.

Neni 11

Ekzekutimi në kohë

1. Kur shoqëria administruese e fondeve vendos të ekzekutojë një urdhër për sipërmarrjen ose nënfondin, ajo e ekzekuton urdhrin sapo të jetë koha e përshtatshme sipas rrethanave për ta kryer këtë veprim.
2. Kryerja e transaksionit duhet të specifikojë kohën dhe datën përkatëse në mënyrë që të ofrojë dëshmi për afatet kohore dhe prioritetin e urdhrave. Në rastin e kryerjes së transaksionit koha e ekzekutimit të urdhërit duhet të vendoset automatikisht nga sistemi i tregtimit që përdor shoqëria administruese.

Neni 12

Trajtimi i incentivave nga palë të treta

1. Shoqëria administruese e fondeve, gjatë ekzekutimit të urdhrave ose vendosjes së urdhrave për ekzekutim në subjekte të tjera, për një sipërmarrje ose nënfond, nuk duhet të pranojë asnjë incentivë që është e lidhur me instrumentet financiare.
2. Gjatë ekzekutimit të urdhrave, ose vendosjes së urdhrave për ekzekutim në subjekte të tjera, që kanë të bëjnë me instrumentet financiare për një sipërmarrje ose nënfond, shoqëria administruese e fondeve nuk pranon dhe nuk tarifon asnjë tarifë, komision ose përfitim monetar ose përfitim jomonetar kur ato paguhen ose ofrohen nga ndonjë palë e tretë ose një person që vepron në emër të një pale të tretë.
3. Në një raport vjetor të dhënë me kërkesë të investitorëve, shoqëria administruese e fondeve duhet të informojë investitorët e sipërmarrjes ose nënfondit për tarifën, komisionet ose përfitimet monetare që u janë transferuar atyre.

Neni 13

Përfitimet e pranueshme

1. Shoqëria administruese e fondeve nuk duhet të pranojë përfitim jo monetar, me përjashtim të rastit kur është një përfitim i vogël jomonetar i cili është i arsyeshëm, proporcional dhe i një shkalle që nuk ka mundësi të ndikojë në sjelljen e shoqërisë administruese të fondeve në mënyrë që të rezultojë në dëmin e interesave të sipërmarrjes ose nënfondit, dhe që konsiston në sa më poshtë:
 - a) Informacion ose dokumentacion në lidhje me një instrument financiar që është i përgjithshëm në natyrë;
 - b) Materiale të shkruara nga një palë e tretë e porositur dhe e paguar nga emetuesi aktual ose potencial i një shoqërie tregtare për të promovuar një emetim kësaj shoqërie, kur pala e tretë është e angazhuar kontraktualisht dhe e paguar nga emetuesi;
 - c) Pjesëmarrje në konferenca, seminare dhe trajnime të tjera në lidhje me përfitimet e një instrumenti financiar specifik;
 - d) Shpenzime pritje percjellje në një vlerë minimale të arsyeshme, të tilla si ushqimi dhe pijet gjatë një takimi biznesi ose ndonjë trajnimi tjetër;
 - e) Kërkime që kanë të bëjnë me emetimin e titujve nga një emetues, në dispozicion të investitorëve të ardhshëm të këtij emetimi, të përgatitura nga një person që ofron nënshkrimin ose shërbime të porosisë për emetuesin për atë emetim;
 - f) Përfitimi i vogël jomonetar i pranueshëm i përbërë nga informacioni ose dokumentacioni që lidhet me një instrument financiar që është i përgjithshëm në natyrë i përcaktuar në shkronjën a), të pikës 1 të këtij neni, mund të përfshijë materialin e ofruar nga një palë e tretë, që është një shpjegues afatshkurtër i tregut mbi statistikën e fundit ekonomike, rezultatet e shoqërisë tregtare ose informacion mbi të rejtat ose ngjarjet e ardhshme.

SEKSIONI 2

KONFLIKTET E INTERESIT SI PENGESË PËR EKZEKUTIMIN MË TË MIRË

Neni 14

Kriteret për identifikimin e konfliktit të interesit

1. Shoqëria administruese e fondeve, me qëllim identifikimin e llojeve të konfliktit të interesit që lindin gjatë ofrimit të shërbimeve dhe veprimtarive, ekzistenca e të cilave mund të dëmtojë interesat e sipërmarrjes ose të nënfondit, merr në konsideratë, çështjen nëse shoqëria administruese e fondeve ose një person që është person i lidhur fizik ose juridik i shoqërisë administruese të fondeve, ndodhet në një nga situatat e mëposhtme, si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së administrimit të fondeve por jo vetëm:
 - a) Shoqëria administruese e fondeve ose personi fizik/juridik i lidhur ka të ngjarë të ketë një përfitim financiar, ose të shmangë një humbje financiare, në dëm të sipërmarrjes ose të nënfondit;

- b) Shoqëria administruese e fondeve ose personi fizik/juridik i lidhur ka interes në rezultatin e një shërbimi ose të një aktiviteti që i ofrohet sipërmarrjes ose nënfondit, ose një klienti tjetër, ose në rezultatin e një transaksioni të kryer në emër të sipërmarrjes ose të nënfondit ose një klient tjetër, i cili dallon dhe është i ndryshëm nga interesi i sipërmarrjes ose i nënfondit;
 - c) Shoqëria administruese e fondeve ose personi fizik/juridik i lidhur ka incentiva financiare ose incentiva të tjera për të favorizuar interesin e një klienti ose grupi klientësh të tjerë, të ndryshme nga interesat e sipërmarrjes ose të nënfondit;
 - d) Shoqëria administruese e fondeve ose personi fizik/juridik i lidhur kryen të njëjtat aktivitete si për sipërmarrjen ose nënfondin ashtu dhe për një ose disa klientë të tjerë që nuk janë sipërmarrja ose nënfondi;
 - e) Shoqëria administruese e fondeve ose personi fizik/juridik i lidhur merr ose do të marrë nga një person tjetër i ndryshëm nga sipërmarrja ose nënfondi, përfitime në lidhje me aktivitetet e administrimit të portofolit kolektiv që i ofrohen sipërmarrjes ose nënfondit, në formën e parave, mallrave ose shërbimeve, të ndryshme nga komisioni ose tarifa standarde e atij shërbimi.
2. Shoqëria administruese e fondeve, në identifikimin e llojeve të konfliktit të interesave, merr parasysh sa më poshtë:
- a) Interesat e shoqërisë administruese të fondeve, duke përfshirë ato që rrjedhin nga përgjegjësia e saj në një grup ose nga kryerja e shërbimeve dhe aktiviteteve, interesat e investitorëve/klientëve dhe detyrat e shoqërisë administruese të fondeve ndaj sipërmarrjes ose nënfondit;
 - b) Interesat e ndryshme të dy ose më shumë sipërmarrjeve ose nën-fondeve nën administrimin e saj.

Neni 15

Shoqëria administruese e fondeve që është pjesë e një grupi financiar

1. Shoqëria administruese e fondeve duhet të hartojë procedura dhe të marrë masa në përputhje me këtë nen, në mënyrë që të sigurohet që personat përgjegjës të angazhuar në aktivitete të ndryshme të veprimtarisë që kanë një konflikt interesi, t'i kryejnë ato aktivitete në një nivel pavarësie të përshtatshme me madhësinë dhe aktivitetet e shoqërisë administruese të fondeve dhe të grupit financiar të cilit i përket dhe me materialitetin e rrezikut të dëmtimit të interesave të klientëve.
2. Shoqëria administruese e fondeve, për të siguruar shkallën e kërkuar të pavarësisë, përfshin aty ku është e nevojshme dhe e përshtatshme procedurat që duhet të ndiqen dhe masat që duhet të merren, si më poshtë:
 - a) Procedura efektive për të parandaluar ose kontrolluar shkëmbimin e informacionit ndërmjet personave përgjegjës të angazhuar në aktivitete të administrimit të portofolit kolektiv që përfshin rrezikun e konfliktit të interesit, kur shkëmbimi i këtij informacioni mund të dëmtojë interesat e një ose më shumë investitorëve të sipërmarrjes ose nënfondit nën administrim;

- b) Mbikëqyrje e veçantë e personave përgjegjës, funksionet kryesore të të cilëve përfshijnë kryerjen e veprimtarive të administrimit të portofolit kolektiv, ose ofrimin e shërbimeve për sipërmarrjet, nënfondet ose investitorët, interesat e të cilëve mund të bien ndesh ose përfaqësojnë interesa të ndryshme që mund të krijojnë konflikt, përfshirë këtu ato të shoqërisë administruese;
 - c) Eliminimi në rastet kur ka konflikt interesi i çdo lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet shpërblimit të personave përgjegjës të angazhuar në një aktivitet dhe shpërblimit ose të ardhurave të gjeneruara nga persona të tjerë përgjegjës të angazhuar në një aktivitet tjetër,
 - d) Masa për të parandaluar ose kufizuar çdo person që të ushtrojë ndikim të papërshtatshëm mbi mënyrën se si një person përgjegjës kryen aktivitete të administrimit të portofolit kolektiv;
 - e) Masa për të parandaluar ose kontrolluar përfshirjen njëkohësisht ose të njëpasnjëshme të një personi përgjegjës në aktivitete të veçanta të administrimit të portofolit, ku përfshirja mund të pengojë manaxhimin e duhur të konflikteve të interesit.
3. Nëse miratimi ose përdorimi i një ose më shumë prej këtyre masave dhe procedurave nuk garanton nivelin e duhur të pavarësisë, Autoriteti i kërkon shoqërisë administruese të fondeve të miratojë masa dhe procedura të tjera alternative ose shtesë që janë të nevojshme dhe të përshtatshme për këto qëllime.
 4. Dokumenti i politikës dhe procedurave të konfliktit të interesit të shoqërisë administruese të fondeve të kërkuara nga neni 17, pika 2, shkronja ë) nën ndarja iii) i Ligjit përfshin dispozitat të përcaktuara sipas këtij neni si dhe rishikohet dhe përditësohet rregullisht.

Neni 16

Monitorimi i politikave të ekzekutimit të urdhrave

1. Shoqëria administruese e fondeve monitoron efektivitetin e marrëveshjeve të ekzekutimit të urdhrave dhe politikën e ekzekutimit me qëllim që të identifikojë dhe, kur është e përshtatshme, të korrigjojë ndonjë mangësi. Në veçanti, duhet të vlerësojë në baza të rregullta nëse platformat e ekzekutimit të përfshira në politikën e ekzekutimit të urdhrave sigurojnë rezultatin më të mirë të mundshëm për sipërmarrjen, investitorin/klientin.

Neni 17

Konfliktet e interesit dhe transaksionet personale

1. Shoqëria administruese e fondeve, në rastin e personit përgjegjës që është i përfshirë në aktivitete që mund të shkaktojnë konflikt interesi, ose që ka akses në informacionin e brendshëm ose informacione të tjera konfidenciale në lidhje me sipërmarrjen ose nënfondin ose në transaksionet për një sipërmarrje ose një nënfond në bazë të një

veprimtarie të kryer prej këtij personi në emër të shoqërisë administruese të fondeve, duhet të krijojë, zbatojë dhe marrë masa të përshtatshme që synojnë parandalimin e aktiviteteve si më poshtë:

- a) Hyrja në një transaksion personal i cili përmbush të paktën një nga kriteret e mëposhtme:
 - i) Ky person ndalohet të kryejë këtë transaksion personal;
 - ii) Transaksioni përfshin keqpërdorimin ose informimin jo të duhur të informacionit konfidencial;
 - iii) Transaksioni bie ndesh me një detyrim të shoqërisë administruese të fondeve sipas ligjit ose rregulloreve të tij;
 - iv) Këshillimi ose sigurimi, përveçse kur parashikohet në kushtet e kontratës së punës apo shërbimit, i çdo personi tjetër që të kryejë transaksion me instrumente financiare të cilat, në rast të transaksionit personal të personit përgjegjës, mbulohen nga shkronja i) e kësaj pike, ose të cilat përbëjnë një keqpërdorim të informacionit në lidhje me urdhrat në pritje;
 - v) Dhënia, përveçse në rrjedhën normale të punësimit ose kontratës së shërbimit, të çdo informacioni ose mendimi një personi tjetër, nëse personi përgjegjës e di ose në mënyrë të arsyeshme duhet të dijë, se si rezultat i dhënies së këtij informacioni, personi tjetër do të kishte mundësi për të marrë një nga hapat e mëposhtëm:
 - a. Të kryejë transaksion me instrumente financiare të cilat, në rast të transaksionit personal të personit përgjegjës, mbulohet nga shkronja i) e kësaj pike, ose të cilat përbëjnë një keqpërdorim të informacionit në lidhje me urdhrat në pritje;
 - b. Të këshillojë ose të shtyjë një person tjetër për të kryer këtë transaksion.

2. Masat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni në veçanti hartohen për të siguruar që:
 - a) Çdo person përgjegjës i mbuluar nga pika 1 i këtij neni është i vetëdijshëm për kufizimet në transaksionet personale dhe masat e vendosura nga shoqëria administruese e fondeve në lidhje me transaksionet personale dhe dhënien e informacionit, në përputhje me pikën 1 të këtij neni;
 - b) Shoqëria administruese e fondeve informohet menjëherë për çdo transaksion personal të lidhur nga një person përgjegjës, ose nëpërmjet njoftimit të këtij transaksioni ose nëpërmjet procedurave të tjera që i mundësojnë shoqërisë administruese të fondeve të identifikojnë këto transaksione;
 - c) Mbahen të dhëna për transaksionet personale të njoftuara ose identifikuar nga shoqëria administruese e fondeve, duke përfshirë çdo autorizim ose ndalim në lidhje me këtë transaksion.
3. Për qëllimet e pikës 1, shkronjës a) nën ndarjes ii) të këtij neni, nëse aktivitete të caktuara kryhen nga palë të treta, shoqëria administruese e fondeve garanton që subjekti që kryen aktivitetin mban një regjistër të transaksioneve personale të lidhura nga çdo person përgjegjës dhe ja mundëson informacionin shoqërisë administruese të fondeve menjëherë pas kërkesës.

Neni 18

Përrjashtimi i llojeve të caktuara të transaksioneve personale

1. Pikat 1 dhe 2 të nenit 17 të kësaj rregulloreje nuk zbatohen për llojet e mëposhtme të transaksioneve personale:
 - a) Transaksionet personale të kryera në kuadër të një shërbimi të administrimit të portofolit në mënyrë diskrecionale, nëse nuk ka komunikim paraprak në lidhje me transaksionin midis administruesit të portofolit dhe klientit ose personit tjetër për llogari të të cilit ekzekutohet transaksioni;
 - b) Transaksionet personale në aksione ose kuota në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike që janë subjekt i mbikëqytjes së Autoritetit ose një autoriteti të huaj rregullator.

Neni 19

Regjistrimi i transaksioneve

1. Shoqëria administruese e fondeve duhet të sigurohet, që për çdo transaksion të portofolit që lidhet me sipërmarrjen ose nën-fondin, të regjistrohen pa vonesë informacione që janë të mjaftueshme për të rindërtuar detajet e urdhrit dhe transaksionit të ekzekutuar.
2. Informacioni i referuar në pikën 1 të këtij neni përfshin:
 - a) Emrin ose emërtimin tjetër të sipërmarrjes ose të nën-fondit dhe të personit që vepron për llogari të sipërmarrjes ose të nën-fondit;
 - b) Detajet e nevojshme për të identifikuar instrumentin në fjalë;
 - c) Sasinë;
 - d) Llojin e urdhrit ose transaksionit;
 - e) Çmimin;
 - f) Për urdhrat, datën dhe orën e saktë të dërgimit të urdhrit dhe emrin ose emërtimin tjetër të personit të cilit i është dërguar urdhri ose për transaksionet, datën dhe kohën e saktë të vendimit për të trajtuar dhe ekzekutuar transaksionin;
 - g) Emrin e personit që dërgon urdhrin ose që ekzekuton transaksionin;
 - h) Aty ku është e aplikueshme, arsyet për revokimin e urdhrit;
 - i) Për transaksionet e ekzekutuara, palën tjetër dhe identifikimin e vendit të ekzekutimit.

SEKSIONI 3

TRANSAKSIONET QË PËRFSHIJNË SUBJEKTE TË LIDHURA, PERSONA FIZIKË TË LIDHUR DHE ATA ME LIDHJE PRONËSIE

Neni 20

Transaksionet që përfshijnë subjekte të lidhura, persona fizikë të lidhur dhe ata me lidhje pronësie

1. Shoqëria administruese e fondeve, lidhur me çdo sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike që administron, nuk kryen asnjë transaksion me persona me të cilët ka lidhje pronësie ose me të cilët është subjekt i lidhur që rezultojnë në përfitime të padeklaruarra për secilën nga të dyja palët ose kur përfitimet, që rrjedhin nga transaksioni nuk do të kishin lindur nëse transaksioni do të ishte kryer me kushte normale tregu në momentin e transaksionit.
2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, do të konsiderohet se transaksioni ka rezultuar në përfitime të padeklaruarra për secilën palë nëse ai nuk është kryer sipas parimit ‘*arms length*’.
3. Shoqëria administruese mund të kryejë transaksione me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar të shoqërisë kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) Transaksioni ka si objekt investimet e likuiditeteve të fondit të investimeve të kryera në një bursë ose treg të organizuar me kushtin që çmimi i transaksionit të jetë brenda kushteve të tregut sipas parimit “*arms length*” dhe palët e përfshira në transaksion të mos kenë rënë dakord në lidhje me çmimin përpara marrjes së vendimit për të kryer transaksionin;
 - b) Transaksionet që kanë si objekt shitjen e titujve të fondit të investimeve, me qëllimin e mbajtjes së treguesve të likuiditetit apo kërkesave të tjera rregullatore të kryera në një bursë apo treg të organizuar ose në një treg të rregulluar, me kushtin që çmimi i transaksionit të jetë brenda kushteve të tregut sipas parimit “*arms length*” dhe palët e përfshira në transaksion të mos kenë rënë dakord në lidhje me çmimin përpara marrjes së vendimit për të kryer transaksionin;
 - c) Transaksionet e titujve në një treg të rregulluar, me kushtin që çmimi i transaksionit të jetë brenda kushteve të tregut, sipas parimit “*arms length*” dhe në interesin më të mirë të investitorëve. Transaksioni duhet të kryhet nëpërmjet platformave *Reuters* ose *Bloomberg* ose mjeteve të tjera të komunikimit, dhe
 - i. Transaksioni kryhet me një broker/dealer ndërkombëtar, i cili kuoton rregullisht në atë instrument, me çmime të ekzekutueshme;
 - ii. Transaksioni kryhet me një broker/dealer lokal, i cili kuoton rregullisht në atë instrument, me çmime të shfaqura rregullisht në faqen e tij të kuotimit dhe të ekzekutueshme.
 - d) Transaksionet të cilat kryhen në një treg të rregulluar të cilat nuk përfshihen tek shkronja “c”, e pikës 3, të këtij neni dhe të cilat deklarohen nga shoqëria administruese se janë kryer sipas parimit “*arms length*”, të mbështetur me dokumentacion.
 - e) Transaksionet të cilat kanë si objekt titujt ose instrumentat e tregut të parasë të emetuara dhe/ose garantuara nga organet e qeverisjes qendrore dhe vendore të Republikës së Shqipërisë të blera drejtpërdrejt në ankandin primar sipas kushteve më të mira të tregut.

- f) Të gjitha transaksionet të cilat kanë si objekt titujt që emetohen për herë të parë me ofertë fillestare, të kryera sipas kushteve më të mira të tregut.
4. Transaksionet që përfshihen në shkronjën “e” dhe shkronjën “f” të pikës 3, të këtij neni konsiderohen “*arms length*”.
5. Depozitari shqyrton dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Shoqëritë Administruese sipas Shtojcës 1, dhe njofton në Autoritet nëse nuk është zbatuar parimi “*arms length*”.

Neni 21

Ndalimi i praktikave abuzive

Transaksionet me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar, të cilat kryhen për të rritur/ose ulur çmimin e kuotave të fondit, në mënyrë artificiale, me qëllim që të nxisin investitorët e tjerë, ose publikun e gjerë të blejnë ose të shesin kuotat janë të ndaluara, dhe subjekt i dispozitave përkatëse të ligjit “Për tregjet e kapitalit” në lidhje me abuzimin me tregun.

Neni 22

Regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave

Të gjitha komunikimet me brokerat duhet të jenë të regjistruara. Shoqëria administruese është e detyruar të mbajë të dhëna dhe dokumentacion për transaksionet me palët e lidhura deri në 7 (shtatë) vjet pas kryerjes së transaksionit. Autoriteti ka të drejtën për të kërkuar në çdo kohë të gjitha të dhënat, regjistrimet e telefonatave dhe komunikimeve, printime të kuotimeve në momentin që është kryer transaksioni, për të verifikuar përputhshmërinë me këtë rregullore.

KREU III

PROCEDURA PËR VLERËSIMIN, ÇMIMIN, SHITJEN DHE SHLYERJEN E KUOTAVE TË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE NGA SHOQËRITË ADMINISTRUESE TË FONDEVE

SEKSIONI I

LLOGARITJA E VLERËS NETO TË AKTIVEVE PËR KUOTË OSE AKSION

Neni 23

Metodologjia e vlerësimit

1. Rregullat e hollësishme për mënyrën e vlerësimit të të gjitha llojeve të aktiveve dhe pasiveve të sipërmarrjeve dhe nën-fondeve të investimeve kolektive të përcaktuara në

dispozitat e këtij Kreu, zbatohen për shoqërinë administruese të fondeve kur kryen vlerësimin e sipërmarrjeve dhe të nënfondeve që ajo administron dhe për depozitarin në kontrollin e vlerësimit.

2. Shoqëria administruese e fondeve përcakton se si zbatohen rregullat për vlerësimin për secilin lloj të aktivitetit të zotëruar në sipërmarrjet e investimeve kolektive ose nënfondet dhe shpeshësinë e vlerësimeve për secilin lloj të sipërmarrjes së investimeve kolektive ose të nënfondit që administron.
3. Shoqëria administruese e fondeve duhet gjithashtu të përcaktojë, në lidhje me fondet e investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale, metodën për llogaritjen e çmimit të shitjes, të shlyerjes, të krijimit dhe të anulimit të kuotave të këtyre fondeve.

Neni 24

Llogaritja e vlerës së aktiveve

Llogaritja e vlerës së aktiveve dhe pasiveve të një sipërmarrjeje ose nën-fondi të investimeve kolektive kryhet në përputhje me llojet e ndryshme të aktiveve dhe klasifikimin e aktiveve në Seksionin 3 të këtij Kreu.

Neni 25

Vlera neto e aktiveve dhe vlera neto e aktiveve për kuotë ose aksion

1. Instrumentet financiare të listuara dhe të tregtuara në një treg aktiv vlerësohen në bazë të çmimit më të fundit të tregut në momentin e vlerësimit siç kërkohet nga neni 32, pika 6, shkronja a) të Ligjit.
2. Instrumentet financiare, tregtimi i të cilave është joaktiv vlerësohen sipas metodologjisë së parashtruar në nenin 23 të kësaj rregulloreje pas dakordësimit me depozitarin.

Neni 26

Tregjet aktive

1. Çmimi i tregut në një treg aktiv garanton dëshminë më të besueshme të vlerës së drejtë dhe përdoret pa përshtatje për të matur vlerën e drejtë sa herë që është e mundur, me përjashtime të kufizuara.
2. Për qëllime të kësaj rregulloreje, treg aktiv është tregu në të cilin transaksionet për aktivin ose detyrimin kryhen me frekuencë të mjaftueshme dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në mënyrë të vazhdueshme.
3. Do të konsiderohen tregje aktive nëse:

- a. Instrumenti tregtohet në një nga tregjet e listuara ne shtojcën 2 të kësaj rregulloreje;
 - b. Në lidhje me instrumentet e borxhit është vlerësuar nga një prej agjencive të vlerësimit të kreditit S&P, Moody's ose Fitch në shkallën "gradë investimi" (investment grade);
4. Në lidhje me titujt e tjerë të cilat nuk përmbushin kërkesat e pikës 3 të këtij neni, frekuenca e mjaftueshme e tregtimit është:
 - a) Ku ka kuotime të ekzekutueshme në baza ditore;
 - b) Në rastin e titujve të kapitalit kur ka tregtim të titullit në fjalë për të paktën 20 ditë tregtimi në një periudhë prej nëntëdhjetë ditëve tregtimi;
 - c) Në rastin e titujve të borxhit kur ka tregtim të titullit në fjalë për të paktën 15 ditë tregtimi në një periudhë prej nëntëdhjetë ditëve tregtimi.
 5. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, tregu kryesor është tregu i cili zakonisht ka volumin dhe nivelin më të madh të aktivitetit për aktivin ose detyrimin, ose një treg tjetër, i ndryshëm nga tregu kryesor, që në kohën e vlerësimit, gjykohet të jetë tregu më i favorshëm, d.m.th. tregu që maksimizon shumën që do të merrej për të shitur aktivin ose detyrimin në atë kohë.
 6. Vetëm për qëllime të vlerësimit, duhet të përdoren çmimet e kuotuar në tregjet aktive për aktivet ose detyrimet identike që shoqëria administruese e fondeve dhe depozitari mund të ketë akses në datën e vlerësimit.
 7. Çmimet e përdorura për vlerësim duhet të jenë çmimet më të fundit në dispozicion menjëherë para pikës së vlerësimit.
 8. Nëse nuk përmbushet ndonjë nga kushtet e përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, titulli trajtohet sikur nuk është tregtuar në treg aktiv dhe vlerësohet në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë rregullore për vlerësimin e titujve në tregjet joaktive.
 9. Vlerësimi i tregut duhet të bëhet me frekuencë 3 mujore.

Neni 27

Kritere të tjera në lidhje me përcaktimin e statusit të tregut

1. Përveç përcaktimeve në nenin 26 të kësaj rregulloreje, shoqëria administruese për titujt e pjesëmarrjes në kapital (*equities*) do të përcaktojë nëse vepron në treg aktiv apo jo aktiv duke marrë parasysh edhe:
 - a. Vëllimin e tregtimit të krahasuar me vëllimin mesatar të tregtimit për periudhën tremujore;
 - b. Diferencën ndërmjet çmimit më të fundit të ofruar për blerje dhe çmimit më të fundit të ofruar për shitje;
 - c. Vëllimin e tregtimit në raport me kapitalizimin e tregut në periudhë tremujore.

Neni 28
Përgjegjësia për të përcaktuar statusin e tregut

1. Shoqëria administruese e fondeve përjashtimisht nga pika 3 e nenit 26 duhet të krijojë një procedurë për kryerjen e rregullt të kontrolleve të përshtatshme të përcaktuar nëse një treg është:
 - a) Treg aktiv;
 - b) Treg jo aktiv por që ekzistojnë çmime për instrumentet financiare të zotëruara nga sipërmarrja ose nënfondi;
 - c) Treg jo aktiv në të cilin nuk ka çmime për instrumentet financiare të zotëruara nga sipërmarrja ose nënfondi.
2. Shoqëria administruese e fondeve dhe depozitari i sipërmarrjes krijojnë dhe dokumentojnë procedurën për vërtetimin e gjykimit të tyre për klasifikimin e secilës kategori të tregut dhe çdo lloj instrumenti financiar në të.
3. Shoqëria administruese e fondeve dhe depozitari krijojnë dhe dokumentojnë metodologjinë e vlerësimit për vlerësimin e aktiveve dhe detyrimeve në secilën kategori të tregjeve.
4. Metodologjia e vlerësimit për secilën sipërmarrje duhet të përcaktohet nga shoqëria administruese e fondeve dhe të konsultohet me depozitarin si dhe të jetë pjesë e opinionit të pasqyrave financiare të audituesit të jashtëm të sipërmarrjes dhe dorëzohet në Autoritet.

SEKSIONI 2
KONTABILITETI DHE PARIMET E VLERËSIMIT

Neni 29
Vlerësimi i aktiveve në monedhë të huaj

1. Sipërmarrjet dhe nënfondet për të cilat, çmimi dhe vlera neto e aktiveve është shprehur në lekë dhe që zotërojnë aktive, çmimet e të cilave shprehen në monedhë të huaj, duhet të llogarisin vlerën e zotërimit në ekuivalentin në lekë, duke zbatuar kursin e këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë, në ditën e vlerësimit.
2. Sipërmarrjet dhe nënfondet, vlera neto e aktiveve e të cilave shprehet në monedha të ndryshme nga leku shqiptar duhet të konvertojnë vlerën e aktiveve të tyre, çmimet e të cilave janë shprehur në monedha të ndryshme nga monedha bazë e sipërmarrjes ose nënfondit, në monedhën bazë në të cilën shprehen aksionet ose kuotat me kursin e këmbimit në fuqi në ditën e vlerësimit.

Neni 30

Kontabilizimi për transaksionet e portofolit

1. Blerjet dhe shitjet e aktiveve të sipërmarrjes ose nën фондеve do të përfshihen në vlerësimin e aktiveve në ditën kur transaksioni është përfunduar. Dita kur transaksioni është përfunduar do të quhet dita kur është mbyllur marrëveshja e tregimit (*trade date*) nëpërmjet shoqërisë administruese dhe shoqërisë komisionere/bankës që ofron shërbime investimesh me të cilën është kryer transaksioni.
2. Në rastin e blerjes së një aktivi financiar, transaksioni i përfunduar do të njihet si aktiv i sipërmarrjes ose nënfondit, duke krijuar në të njëjtën kohë detyrimin për shlyerje.
3. Në rastin e shitjes së një aktivi financiar në ditën e përfundimit të transaksionit, aktivi nuk do të bëjë më pjesë në aktivet e sipërmarrjes dhe do të njihet e drejta e transaksionit të përfunduar.

Neni 31

Kontabilizimi për blerjet në emetimin primar

Blerja e aktiveve të emetimeve primare do të njihet në aktivet e sipërmarrjes në datën e tregimit. Në rastet e blerjes së aktiveve të emetimeve primare nëpërmjet një ankandi, këto aktive do të njihen në aktivet e sipërmarrjes në datën e konfirmimit dhe shpalljes fitues të ankandit.

Neni 32

Kontabilizimi për shpenzimet kur investohen në фонде që administrohen nga e njëjta shoqëri administruese

Në rastin kur sipërmarrja ose nënfondi investon në sipërmarrje ose nënфонде të tjera të administruara nga e njëjta shoqëri administruese e фондеve, tarifa administruese që paguhet për shoqërinë e administrimit të фондеve mund t'i tarifohet ose sipërmarrjes së investimeve kolektive/nënfondit që po investon ose sipërmarrjes së investimeve kolektive/nënfondit në të cilin është bërë investimi, por jo të dyjave.

SEKSIONI 3

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË KATEGORIVE DHE LLOJEVE TË NDRYSHME TË AKTIVEVE NGA SHOQËRITË ADMINISTRUESE TË FONDEVE

Neni 33

Vlerësimi i instrumenteve financiare të tregtuara në një treg aktiv

1. Për instrumentet financiare të tregtuara në një treg aktiv, vlera e instrumentit financiar

Ilogaritet duke shumëzuar çmimin e tregut më të fundit të disponueshëm me numrin e instrumenteve financiare të zotëruara nga sipërmarrja ose nënfondi.

2. Çmimi i tregut i fundit është çmimi më i fundit i disponueshëm në treg i çmimit në blerje “*bid*” të instrumentit përkatës financiar menjëherë para kohës në të cilën bëhet vlerësimi.
3. "Më i fundit i disponueshëm" nënkupton një çmim jo më të vjetër se çmimi i fundit i paraqitur në ditën më të fundit të punës; ose
 - a) Çmimi me të cilin transaksioni më i fundit në instrumentin përkatës financiar është raportuar në një treg të rregulluar ose në tregjet mbi bankë; ose
 - b) Çmimi me të cilin një krijues tregu (*market maker*) ose “internalizues sistematik” kuoton për të blerë instrumentin përkatës financiar në një treg në të cilin ka krijuar tregu ose internalizues sistematikë. Në rastet kur ka disa krijues tregu ose internalizues sistematikë përdoret mesatarja e ponderuar e çmimit me vëllimet e kuotuar.

Neni 34

Përfshirjet nga vlerësimi i instrumenteve financiare të tregtuara në një treg aktiv

1. Çmimet e aktiveve të tregtuara në mënyrë aktive nuk janë të besueshme nëse:
 - a) Tregu ose mekanizmi tjetër i tregtimit ku tregtohet aktivi është subjekt i mbylljes së përkohshme;
 - b) Instrumenti financiar në fjalë ka pasur kuotimin e tij të pezulluar përkohësisht nga tregu ose mekanizmi tjetër i tregtimit për çfarëdo lloj arsye;
 - c) Ka ndodhur një ngjarje e rëndësishme që nga mbyllja më e fundit e tregut kur është marrë çmimi i instrumentit financiar.
2. Shoqëria administruese e fondeve përdor çmimet e vlerës së drejtë në rastin e aktiveve të tregtuara në mënyrë aktive kur:
 - a. Nuk ka besueshmëri në çmimin që rrjedh nga tregu aktiv, ose
 - b. Ka baza të arsyeshme për të besuar se nuk ekziston ndonjë çmim i besueshëm për një instrument financiar në një pikë vlerësimi, ose
 - c. Nëse çmimi më i fundit i disponueshëm nuk pasqyron vlerësimin më të mirë të shoqërisë administruese të fondeve për vlerën e një aktivi në pikën e vlerësimit.
3. Nëse shoqëria administruese e fondeve beson se vlera e drejtë nuk mund të përcaktohet nga asnjë prej teknikave të çmimit të vlerës së drejtë, atëherë ajo informon Autoritetin se synon të pezullojë të gjitha veprimet me kuotat e fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur ose me intervale deri sa të rivendoset çmimi i tregut.

Neni 35

Vlerësimi për titujt e tregtuar për të cilët ekziston një treg jo aktiv

1. Kur transaksionet për aktivin ose detyrimin në një treg të rregulluar ose platformë tjetër tregtimi nuk zhvillohen me frekuencë të mjaftueshme dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në mënyrë të vazhdueshme siç kërkohet sipas nenit 26 të kësaj rregulloreje, tregu i këtyre aktiveve duhet të konsiderohet si joaktiv.
2. Në rastin e instrumenteve financiare të tregtuara në një treg të rregulluar jo aktiv, mund të jetë e mundur të sintetizohet një çmim tregu nëpërmjet:
 - a) Marrjes së ofertave nga shoqëritë komisionere/bankat që ofrojnë shërbime investimesh ose krijuesit e tregut të cilët duhet të jenë:
 - i) Mesatarja e çmimeve në blerje “*bid*” nga të paktën tre brokera ose krijues tregu;
 - ii) Të ekzekutueshëm idealisht edhe në sasi të vogla.
 - b) Përdorimit të çmimeve të nxjerra nga *yield*-et mesatare të ponderuara të ankandëve të fundit të titujve të borxhit sipas nenit 37 të kësaj rregulloreje.
 - c) Përdorimit të teknikës së skontimit të flukseve të parasë (*Discounted Cash Flow* (DCF)) për të përlogaritur vlerën aktuale të flukseve të ardhshme parasë duke përdorur një normat e interesit që dalin nga kurba e *yield*-it.
3. Nëse nuk janë kryer transaksione gjatë 30 ditëve të fundit të tregtimit, çmimi i vlerës së drejtë llogaritet sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje.

Neni 36

Detyrimi për mbajtjen e likuiditetit të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale

Nëse të paktën 50% e portofolit të fondit ose nën-fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale përbëhet nga aktive që tregtohen jo aktivisht, është i detyruar të mbajë rezerva likuiditeti të llogaritura në bazë të Rregullores "Për Investimet dhe Huamarrjen".

Neni 37

Dispozita të veçanta për vlerësimin e obligacioneve për të cilat nuk ka treg aktiv

1. Për çmimin e obligacioneve për të cilat nuk ka treg aktiv mund të përdoret një nga metodat e mëposhtme:
 - a) Përdorimi i kurbës së *yield*-it deri në maturim (*yield to maturity*) nënkupton që një obligacion çmohet në bazë të një kurbe *yield*-i, e cila do të bazohet në kurbën e *yield*-it deri në maturim (*yield to maturity*) për obligacionet qeveritare. Nëse nuk ka çmim të tregut aktiv për obligacionet qeveritare, kurba e *yield*-it mund të sintetizohet duke iu referuar *yield*-eve më të fundit në ankandet primare, si edhe duke përdorur metodën e interpolimit, duke konsideruar *yield*-et e publikuara

- brenda një periudhe kohore jo më shumë se 3 muaj përpara ditës së vlerësimit;
- b) Çdo obligacion i zotëruar nga sipërmarrja ose nënfondi i investimeve kolektive do të vlerësohet duke iu referuar *yield*-it të shlyerjes së obligacioneve e në kurbën e *yield*-it, duke konsideruar numrin e viteve deri në shlyerjen e obligacionit që po vlerësohet. Nëse nuk ka obligacion të saktë të krahasueshëm të përfshirë në të dhënat e përdorura për llogaritjen e kurbës së *yield*-it mund të përdoret interpolimi;
 - c) Kurba e *yield*-it për obligacionet jo-qeveritare vlerësohet duke u bazuar në vlerësimin e kreditit (*credit rating*) të emetuesit dhe në vlerësimin nga shoqëria administruese e fondeve të primit të rrezikut mbi obligacionet qeveritare me të njëjtin maturim që duhet të zbatohet për obligacionet me vlerësim të ndryshëm të rrezikut të kreditit (*credit rating*). Në përlllogaritjen e kurbës së *yield*-it primi i rrezikut i shtohet *yield*-it të obligacioneve qeveritare.
 - d) Për obligacionet e pa vlerësuar që nuk kanë vlerësim krediti (*credit rating*), shoqëria duhet të ketë një metodologji të brendshme të vlerësimit të rrezikut të kreditit për të llogaritur primin e rrezikut, i cili do t'i shtohet *yield*-it të obligacioneve qeveritare. Vlerësimi i kreditit për obligacionet e pa vlerësuar nuk mund të tejkalojë vlerësimet e shtetit përkatës si edhe duhet të marrë parasysh karakteristikat e instrumentit duke e krahasuar me instrumente të ngjashëm në tregje të rregulluara.
2. Vlera mund të përlllogaritet në mënyrë alternative duke përdorur flukset e ardhshme të parasë në lidhje me obligacionin, të skontuara për të përlllogaritur vlerën aktuale duke përdorur një normë skontimi të verifikueshme në mënyrë të pavarur dhe objektivisht, e cila është e barabartë me *yield*-in e një obligacioni të ngjashëm.
 3. Metoda e kostos së amortizuar mund të përdoret për obligacione që kanë më pak se 90 ditë deri në maturim ose për instrumentet e tregut të parasë me një jetëgjatësi prej 90 ditësh ose më pak.

Neni 38

Metodat për çmimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, çmimi i vlerës së drejtë përcaktohet si zbatim i vlerësimit më të mirë të shoqërisë administruese të fondeve për shumën që një sipërmarrje ose një nën-fond mund të marrë nga një shitje, ose që pret të paguajë për blerjen e një ose më shumë instrumenteve financiarë ose madje edhe të një portofoli të tërë instrumentesh financiare, në momentin e vlerësimit të sipërmarrjes ose të nën-fondit, me qëllim të garantimit të paanësisë midis investitorëve në hyrje, në dalje dhe në vazhdim, që përfitohet nga:
 - a) Çmimet e kuotuar për aktivet ose detyrimet e ngjashme në tregjet aktive;
 - b) Çmimet e kuotuar për aktivet ose detyrimet identike ose të ngjashme në tregjet që nuk janë aktive;
 - c) Inputet përveç çmimeve të kuotuar për aktivet ose detyrimet, për shembull:
 - i) Normat e interesit dhe kurbat e *yield*-it të vëzhgueshme në intervalet e zakonshme të kuotuar;

- ii) Volatiliteti i përlllogaritur;
- iii) Spreadi i kreditit;
- iv) inputet që rrjedhin kryesisht nga ose janë konfirmuar nga të dhënat e tregut të vëzhgueshme sipas korrelacionit ose mënyrave të tjera.

Neni 39

Procedurat nëse nuk ka të dhëna të krahasueshme

Nëse nuk ka çmime ose çmime të krahasueshme të vëzhgueshme për aktivet ose pasivet, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, dhe në këtë mënyrë nuk ka çmime të mëparshme për këtë aktiv ose pasiv, pasi ai nuk është listuar ose tregtuar kurrë në platforma të tjera tregtimi, metodologjia që do të zbatohet duhet të bazohet në kritere shtesë.

Neni 40

Vlerësimi i aksioneve ose kuotave të фондеve të investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale

Vlerësimi i aksioneve ose kuotave të фондеve të investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale kryhet duke përdorur sa më poshtë:

- a) Çmimin më të fundit në blerje (*bid*) të kuotës ose aksionit të disponueshëm në kohën e vlerësimit nëse sipërmarrja në fjalë kuotohet me dy çmime (*bid/ask*) ose çmimin e vetëm të mesëm të tregut nëse sipërmarrja në fjalë është me çmim të vetëm;
- b) Nëse nuk ka çmim më të fundit, çmimin e fundit të bërë të ditur nga shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit përkatës, me kusht që kjo të mos jetë më shumë se pesë ditë pune për SIK me ofertë publike ose sipas afatit të publikimit të përcaktuar në Prospekt për SIK të tjera.

Neni 41

Vlerësimi i instrumenteve *derivativë* - kontratat standarde të së ardhmes (*futures*)

1. Transaksionet e çdo kontrate standard të së ardhmes të lidhur me normat e interesit, këmbimet valutore, titujt ose mallrat bazë të kryera në një Bursë të njohur të tregtimit të *derivativeve*, vlerësohen çdo ditë me vlerën e tregut duke përdorur çmimin e kuotuar në blerje (*bid*) për transaksionin e fundit të bërë të ditur.
2. Transaksionet e kontratave standarde të së ardhmes (*futures*), për valutat e huaja vlerësohen çdo ditë në vlerën e drejtë duke zbatuar normën përkatëse ndërbankare të interesit të ofruar për valutën specifike (Euribor, Libor dhe të ngjashme), e cila është kuotuar zyrtarisht.
3. Vlera e drejtë e një transaksioni spot në ditën e vlerësimit përcaktohet duke llogaritur kursin mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën kur janë vlerësuar aktivet e fondit.

4. Nëse nuk ka çmime të kuotuar zyrtarisht për kontratat standarde të së ardhmes në një bursë të njohur të *derivativëve* dhe nuk ka palë të treta të përcaktuara, vlera e drejtë e kontratës standard së të ardhmes sipas përcaktimeve të IFRS.

Neni 42

Vlerësimi i instrumenteve *derivativë* – *opsionet*

Opsionet e tregtuara në një Bursë të njohur të tregtimit të *derivativeve* vlerësohen me çmimin më të fundit të ofertës të tregtimit.

Neni 43

Vlerësimi i marrëveshjeve të riblerjes së titujve

1. Transaksionet e shitjes së titujve dhe riblerjes së këtyre titujve në një ditë të përcaktuar në të ardhmen vlerësohen nga dita e transaksionit në një mënyrë që titujt, objekt i këtij transaksioni, të vazhdojnë të vlerësohen në përputhje me rregullat e zbatueshme të llojit të titullit, ndërsa pasivet për fondet e mjeteve monetare të marra vlerësohen përmes llogaritjes së normës së interesit.
2. Transaksionet e blerjes së titujve dhe rishitjes së këtyre titujve në një ditë të përcaktuar në të ardhmen vlerësohen nga dita e transaksionit, si depozitat në maturim, përmes llogaritjes ditore të interesit.

Neni 44

Depozitat bankare

Depozitat bankare vlerësohen me vlerën nominale dhe interesat duhet t'i kreditohen në llogarinë e të ardhurave.

Neni 45

Vlerësimi i transaksioneve të brendshme

1. Nëse aktivi është shitur nga një sipërmarrje ose një nënfond dhe është blerë nga një sipërmarrje ose një nënfond tjetër i administruar nga e njëjta shoqëri administruese e fondeve, depozitari verifikon sa më poshtë:
 - a) Në rastin e një tregu aktiv, nëse transaksioni është bërë me çmimin e hapjes së tregut në momentin e kryerjes së transaksionit;
 - b) Nëse titulli është subjekt ose i metodologjisë së vlerësimit për tregun joaktiv, që transaksioni është kryer me një vlerë të drejtë tregu.
2. Nëse aktivi blihet nga ose i shitet personit fizik/juridik të lidhur të shoqërisë administruese të fondeve zbatohen dispozitat e kësaj rregulloreje në lidhje me transaksionet me palët e lidhura.

SEKSIONI 4

VERIFIKIMI DHE KONTROLLI I ÇMIMEVE

Neni 46

Verifikimi i çmimeve

1. Në rastet e instrumenteve financiare të listuara dhe të tregtuara në një treg kur ai treg është klasifikuar si aktiv, çmimet e përdorura duhet të rrjedhin ose nga informacioni i ofruar nga vetë tregu i njohur ose nga një ofrues ndërkombëtar i informacionit në lidhje me çmimet e instrumenteve financiarë i pranueshëm nga depozitari dhe Autoriteti.
2. Nëse çmimi i instrumenteve financiare në të cilat ekziston një treg joaktiv bazohet në metodologjinë e përcaktuar në këtë Rregullore, shoqëria administruese e fondeve bie dakord me depozitarin që çmimi është i llogaritur saktë.
3. Metoda e veçantë e përdorur për llogaritjen e vlerës aktuale të një obligacioni duhet të dakordohet me depozitarin dhe të pranohet nga Autoriteti.
4. Nëse ekziston një transaksion midis sipërmarrjes ose nënfondit dhe një personi fizik/juridik të lidhur, depozitari duhet të verifikojë se kjo është kryer në përputhje me kërkesat e rregullores në lidhje me transaksionet me palët e lidhura.

Neni 47

Kontrollet për vlerësimin dhe çmimet

1. Shoqëria administruese e fondeve duhet të vërtetojë se ka kontrolle efektive për llogaritjen e vlerës së aktiveve neto për aksion ose kuotë dhe për çmimet e kuotës.
2. Kontrolli i referuar në pikën 1 të këtij neni garanton që:
 - a) Çmimet e aktiveve janë të sakta dhe të përditësuara;
 - b) Transaksionet e investimeve pasqyrohen në mënyrë të saktë dhe të shpejtë në vlerësimet;
 - c) Komponentët e vlerësimit (duke përfshirë instrumentet financiare, mjetet monetare, dhe kuotat e emetuara), rakordohen rregullisht me burimin e tyre.
 - d) Burimet e çmimeve që nuk merren nga burimi kryesor i çmimit regjistrohen dhe rishikohen rregullisht;
 - e) Dividendët kontabilizohen menjëherë kur titujt kuotohen ex dividend;
 - f) Të ardhurat nga titujt me interes fiks, nga dividendët, interesat dhe shpenzimet përlllogariten dhe kontabilizohen në secilën pikë vlerësimi, ose në kohën kur titulli është ex dividend ose ex interes ose pas marrjes;
 - g) Pozicioni tatimor, përfshirë tatimin në burim, rishikohet dhe përshtatet rregullisht, nëse është e nevojshme;
 - h) Janë vendosur toleranca të arsyeshme për devijimin nga elementet kryesore të një vlerësimi dhe lëvizjet që janë jashtë këtyre tolerancave investigohen;

- i) Shoqëria administruese e fondeve rregullisht shqyrton për saktësi vlerësimin e portofolit.

Neni 48

Shpeshësia e kontrolleve

1. Në ushtrimin e kontrollit të çmimeve, shoqëria administruese e fondeve mund të bëjë zgjedhje të arsyeshme në përcaktimin e shpeshësisë së duhur të funksionimit të kontrolleve dhe mund të zgjedhë një interval më të gjatë, nëse është e përshtatshme, duke pasur parasysh nivelin e aktivitetit të sipërmarrjes ose nënfondit ose rëndësinë e ndikimeve mbi çmimin.
2. Dokumentimi i ushtrimit të kontrollit të çmimeve ruhet në përputhje me periudhën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi.
3. Dokumentimi i gabimeve të vazhdueshme ose të përsëritura në lidhje me këto çështje dhe në veçanti çdo provë e gabimeve të cilat janë në interes të shoqërisë administruese të fondeve ose personave juridik/fizik të lidhur tregon dështim të kontrolleve efektive.
4. Nëse funksioni i vlerësimit dhe përcaktimit të çmimeve i delegohet një pale të tretë, shoqëria administruese e fondeve duhet të rishikojë rregullisht procedurën.

Neni 49

E drejta e Autoritetit të kërkojë përdorimin e një metodologjie të veçantë vlerësimi

1. Autoriteti, kur e gjykon të arsyeshme, mund të udhëzojë shoqërinë administruese të fondeve dhe depozitarin për të rënë dakord dhe për të zbatuar një metodologji të veçantë vlerësimi ose për të ndryshuar një metodologji ekzistuese për çdo kategori ose lloj aktivi, nëse sipas mendimit të tij:
 - a) Metodologjia ekzistuese nuk ofron më një çmim të drejtë tregu;
 - b) Nëse ndryshimet apo zhvillimet në tregjet e njohura e kërkojnë një ndryshim të tillë;
 - c) Nëse ndryshimet në legjislacion e kërkojnë këtë;
 - d) Nëse ka arsye të tjera se pse Autoriteti e konsideron këtë në interes të investitorëve.

SEKSIONI 5 INFORMIMI

Neni 50

Informimi mbi metodat e vlerësimit

1. Metoda e llogaritjes së vlerës që përdoret miratohet nga shoqëria administruese e fondeve dhe nga depozitari dhe përshkruhet në mënyrë të përgjithshme në prospektin SIK.
2. Çdo ndryshim në këto metoda dakordësohet me depozitarin dhe dërgohet në Autoritet.
3. Metodat e reja përfshihen nëpërmjet ndryshimeve të prospektit SIK.

Neni 51

Informimi mbi vlerën e aktiveve neto të sipërmarrjes me pjesëmarrje të mbyllur, e cila është e listuar dhe e tregtuar në një treg të rregulluar

Në rast se shoqëria administruese e fondeve administron një shoqëri investimi ose fond investimi me pjesëmarrje të mbyllur të listuar dhe tregtuar në një treg të rregulluar, vlera neto e aktivitetit dhe çmimi i saj i tregut për aksion ose kuotës, mundësohet si informacion së paku nëpërmjet metodës së shpërndarjes së informacionit të çmimit të tregut të rregulluar dhe vlera neto e aktiveve për aksion ose kuotë e llogaritur nga shoqëria administruese e fondeve publikohet në faqen e internetit të shoqërisë administruese të fondeve sa herë që llogaritet dhe i komunikohet tregut të rregulluar për shpërndarje të informacionit nëpërmjet sistemit të tij informativ.

SEKSIONI 6

LLOGARITJA E ÇMIMEVE TË KUOTAVE

Neni 52

Llogaritja e vlerës neto të aktiveve për kuotë ose aksion

1. Vlera neto e aktiveve për kuotë ose për aksion llogaritet duke zbritur vlerën e detyrimeve nga vlera e aktiveve të sipërmarrjes ose nënfondit në kohën e vlerësimit dhe pjesëtimin e vlerës rezultuese neto të aktiveve të sipërmarrjes ose të nënfondit, të llogaritur në përputhje me kërkesat e këtij Kreu, me numrin e kuotave ose aksioneve në qarkullim në kohën e llogaritjes.
2. Numri i kuotave ose aksioneve në qarkullim është numri i përgjithshëm i mbetur në kohën e vlerësimit.

3. Numri i mbetur është numri i përgjithshëm i krijuar duke zbritur numrin total të shlyer deri në kohën e vlerësimit.
4. Vetëm ato aksione ose kuota që janë paguar dhe shpërndarë te investitorët llogariten për qëllime të llogaritjes së vlerës neto të aktiveve për aksion ose kuota dhe të çmimit të kuotës.
5. Vlera neto e aktiveve për kuota ose aksion mund të jetë e shprehur në lekë ose në një monedhë tjetër, siç përcaktohet në prospektin SIK.
6. Vlera neto e aktiveve për kuota të fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur llogaritet në orën që përcaktohet nga shoqëria administruese dhe deklarohet në prospektin SIK.

Neni 53

Shprehja e çmimit të kuotave të fondeve dhe nënfondeve me pjesëmarrje të hapur dhe me interval

1. Çmimi me të cilin kryhet shitja ose shlyerja, krijimi ose anulimi i kuotave në fondet e investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale si dhe nënfondet, llogaritet dhe shprehet si çmim i vetëm.
2. Shoqëria administruese e fondeve garanton që çmimi i kuotës të çdo klase, të fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me interval të ose nënfondit të llogaritet:
 - a) Duke iu referuar vlerës së përgjithshme neto të aktiveve të fondit ose të nënfondit të investimit të llogaritur në përputhje me dispozitat e këtij Kreu;
 - b) Në përputhje me dispozitat e dokumentit themelues të sipërmarrjes dhe të prospektit SIK.
3. Çmimi i secilës kuota të fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale ose të nënfondit llogaritet duke e pjesëtuar vlerën e aktivitetit neto të llogaritur në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në dispozitat e këtij Kreu me numrin e kuotave të emetuara në kohën kur çmimi është llogaritur.
4. Çdo çmim i kuotës i llogaritur në përputhje me këtë nen duhet të shprehet në një formë që është me së paku katër shifra pas presjes dhjetore.
5. Pjesa e hyrjes, nëse lejohet dhe përcaktohet në prospektin SIK dhe në dokumentin e informacionit kryesor të investitorit, mund të shtohet në vlerën e aktiveve neto të llogaritur në përputhje me pikën 3 të këtij neni. Pjesa e daljes, nëse lejohet dhe përcaktohet në prospektin SIK dhe në dokumentin e informacionit kryesor të investitorit, mund të zbritet nga vlera neto e aktiveve për kuota që i paguhet si shlyerje investitorit.

Neni 54

Llogaritja e gabuar e çmimit të kuotës

1. Shoqëria administruese e fondeve, menjëherë sapo vihet në dijeni mbi gabimin, regjistron çdo rast kur çmimi i kuotës në fondin e investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale ose nënfondit është i pasaktë dhe ja raporton këtë fakt depozitarit së bashku me detajet e veprimeve të ndërmarra, ose që do të ndërmerren, për të shmangur përsëritjen sa më shpejt që të jetë e mundur.
2. Depozitari raporton çdo llogaritje të pasaktë menjëherë te Autoriteti. Raportimi kryhet vetëm për rastet që depozitari i konsideron materiale.
3. Depozitari raporton në Autoritet në baza tremujore duke përmbledhur numrin e rasteve të çmimeve të pasakta të secilës sipërmarrje ose nënfond të cilit i ofrojnë shërbime depozitare gjatë periudhës në fjalë.

Neni 55

Korrigjimi i gabimeve të çmimeve

1. Shoqëria administruese e fondeve, së bashku me depozitarin, njoftojnë menjëherë Autoritetin në rast se çmimi i kuotës së fondit të investimit me pjesëmarrje të hapur ose me intervale ose nënfondit konstatohet të jetë llogaritur gabimisht sepse:
 - a) Metodologjia korrekte për llogaritjen e vlerave neto të aktiveve nuk është zbatuar siç kërkohet nga dispozitat e këtij Kreu;
 - b) Është përdorur një çmim jo i saktë;
 - c) Ka një gabim aritmetik.
2. Shoqëria administruese e fondeve, së bashku me depozitarin, rillogarisin çmimin e kuotës në mënyrë që të përcaktojë çmimin e duhur dhe informojnë për këtë Autoritetin.
3. Në rastin e llogaritjes së pasaktë të çmimit të një kuote në një fond të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale me ofertë publike me mbi 1 %, krahasuar me vlerën e llogaritur nëpërmjet zbatimit të metodologjisë së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit, dhe aktit nënligjor, Autoriteti mund t'i kërkojë shoqërisë administruese përgjegjëse për këtë llogaritje të pasaktë që të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:
 - a. Në rastin kur çmimi i llogaritur për kuotën është më i ulët se vlera korrekte, e përcaktuar sipas kësaj metodologjie, të kompensojë çdo mbajtës të kuotave për çdo diferencë në shumën e marrë nga kuotat e shlyera dhe të kompensojë fondin për çdo diferencë në shumën e arkëtuar për kuotat e shitura;
 - b. Në rastin kur çmimi i llogaritur për kuotën është më i lartë se vlera korrekte, e përcaktuar sipas kësaj metodologjie, të kompensojë çdo mbajtës të kuotave që i blen kuotat nëpërmjet shpërndarjes së kuotave shtesë dhe të kompensojë fondin për çdo vlerë përtej çmimit të paguar për kuotat e shlyera.

Neni 56

Shitja dhe shlyerja e kuotave të fondeve dhe nënfondeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale

1. Çmimi për shitjen dhe shlyerjen e kuotave në fondet e investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale është çmimi i llogaritur në pikën e vlerësimit menjëherë pas kërkesës së vlefshme për nënshkrim ose shlyerje.
2. Të gjitha kërkesat e investitorëve për të nënshkruar apo shlyer kuotat në fondet e investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale të marra pas pikës të mëparshme të vlerësimit plotësohet me çmimin e kuotës për shlyerje e llogaritur në pikën e ardhshme të vlerësimit menjëherë pas kërkesës së vlefshme.

SEKSIONI 7

PROCEDURA E SHITJES DHE E SHLYERJES

Neni 57

Procedura e shitjes dhe e shlyerjes

1. Prospekti SIK mund të lejojë shoqërinë administruese të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale për të identifikuar një pikë në kohë përpara pikës së vlerësimit ("pikë ndërprerje"), pas së cilës nuk pranon urdhra për të shitur ose shlyer kuota në atë pikë vlerësimi.
2. Shoqëria administruese e fondeve bie dakord me depozitarin mbi kohën e pikës së ndërprerjes përpara pikës së vlerësimit.

Neni 58

Marrja dhe kryerja e urdhrave

1. Shoqëria administruese e fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale duhet në çdo kohë gjatë ditës së punës, në varësi të nenit 57 të kësaj rregulloreje të jetë e përgatitur të pranojë të gjitha urdhrat për shitje ose shlyerje që do të përmbushen me çmimin që do të llogaritet në pikën e ardhshme të vlerësimit me përjashtim të rastit kur akti themelues i sipërmarrjes ose nënfondit dhe prospekti SIK lejojnë kufizime në vëllimin e përgjithshëm të urdhrave që mund të përmbushen në çdo pikë vlerësimi sipas nenit 112 të Ligjit, shoqëria administruese e fondit mund të shtyjë çdo urdhër që rezulton në tejkalimin e kufirit deri në pikën e ardhshme të vlerësimit.
2. Të gjithë urdhrat për shitjen ose shlyerjen e kuotave ose shitjen e aksioneve të marra, të pranuar ose të shtyra duhet të përmbajnë datën dhe kohën respektive dhe renditen me prioritet sipas kohës që janë marrë.

KREU IV
DELEGIMI I AKTIVITETEVE TË SHOQËRIVE ADMINISTRUESE TË FONDEVE
NË LIDHJE ME SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE

Neni 59
E drejta për të deleguar

1. Shoqëria administruese të fondeve të sipërmarrjes së investimeve kolektive mund të transferojë ose delegojë, në bazë të një kontrate me shkrim, funksione të caktuara sipas nenit 25 të Ligjit.
2. Shoqëria administruese e fondeve e sipërmarrjes së investimeve kolektive, nuk delegon sa më poshtë:
 - a) Organet drejtuese të shoqërisë administruese të fondeve në përputhje me Ligjin nr.9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar;
 - b) Pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e Autoritetit;
 - c) Politikat e qeverisjes së shoqërisë administruese të fondeve.

Neni 60
Kërkesat lidhur me delegimin nga shoqëritë administruese të fondeve

1. Subjekti të cilit i delegohet shërbimi duhet të ketë aftësinë, kapacitetin, kualifikimet e nevojshme në bazë të ligjit, për të kryer funksionet e deleguara në mënyrë të besueshme dhe profesionale.
2. Subjekti të cilit i delegohet shërbimi duhet të kryejë shërbimet e kontraktuara, dhe për monitorimin me efektivitet të veprimtarive të deleguara, shoqëria administruese e fondeve duhet të vlerësojë performancën e ofruesit të shërbimit.
3. Subjekti të cilit i delegohet shërbimi duhet të monitorojë kryerjen e funksioneve të deleguara, dhe të menaxhojë në mënyrë të përshtatshme rreziqet që lidhen me delegimin.
4. Shoqëria administruese e fondeve ndërmerr masat e përshtatshme nëse ajo gjykon se subjekti të cilit i delegohet shërbimi nuk i kryen funksionet që i janë deleguar në përputhje me ligjet në fuqi dhe kërkesat rregullatore.
5. Shoqëria administruese të fondeve duhet të ketë ekspertizën e nevojshme për të monitoruar funksionet e deleguara në mënyrë efektive dhe për të menaxhuar rreziqet që lidhen me delegimin.
6. Subjekti të cilit i delegohet shërbimi duhet të informojë shoqërinë administruese të fondeve për çdo zhvillim që mund të ketë ndikim të rëndësishëm në aftësinë e tij për të kryer funksionet e deleguara në përputhje me ligjet dhe kërkesat rregullatore në fuqi.

7. Shoqëria administruese e fondeve duhet të jetë në gjendje të përfundojë delegimin e funksioneve, kur është e nevojshme, pa dëmtuar vazhdimësinë dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve për klientët.
8. Subjekti të cilit i delegohet shërbimi duhet të bashkëpunojë me Autoritetin dhe çdo autoritet kompetent përgjegjës dhe në lidhje me aktivitetet e deleguara.
9. Subjekti të cilit i delegohet shërbimi ruan çdo informacion konfidencial në lidhje me shoqërinë administruese të fondeve dhe klientët e saj.
10. Shoqëria administruese e fondeve dhe subjekti të cilit i delegohet shërbimi krijon, zbaton dhe mban një plan të vazhdimësisë së biznesit për rimëkëmbjen në raste fatkeqësish si edhe krijon rezerva “*backup*”, nëse kjo është e nevojshme duke pasur parasysh funksionin, shërbimin ose aktivitetin që është deleguar.

KREU V
KATEGORIZIMI I KLIENTËVE DHE TRAJTIMI I KLIENTËVE NGA
SHOQËRITË ADMINISTRUESE TË FONDEVE DHE AGJENTËT E TYRE TË
SHITJES

SEKSIONI 1
KATEGORIZIMI I KLIENTËVE

Neni 61
Kategorizimi i klientëve

Shoqëria administruese e fondeve dhe agjentët e saj të shitjes përcaktojnë nëse klientët e saj janë klientë profesionistë, të kualifikuar apo klientë jo profesionistë sipas përcaktimeve të ligjit.

Neni 62
Klienti profesionist i riklasifikuar

1. Nëse klienti profesionist kërkon trajtim si klient jo profesionist, klienti do të klasifikohet si një klient jo profesionist nëse lidh marrëveshje me shkrim me shoqërinë administruese të fondeve ose me agjentët e shitjes në mënyrë që të mos trajtohet si një klient profesionist për qëllimet e kësaj Rregulloreje.
2. Kjo marrëveshje specifikon fushën e rikategorizimit, p.sh. nëse ai zbatohet për një ose më shumë shërbime ose transaksione të veçanta, për një ose më shumë lloje të produktit ose transaksionit ose për një ose më shumë rregulla.

Neni 63

Të dhënat mbi kategorizimin e klientëve

1. Shoqëria administruese e fondeve dhe agjentët e saj të shitjes duhet të bëjnë një regjistrim të të dhënave të çdo njoftimi të dhënë dhe çdo marrëveshjeje të lidhur sipas këtij Kreu. Regjistrimi i këtyre të dhënave duhet të bëhet në kohën kur forma standarde përdoret dhe ruhet për herë të parë për periudhën përkatëse të kërkuar nga legjislacioni në fuqi edhe pas periudhës që shoqëria administruese e fondeve ose distributori i saj nuk kryen më veprimtari biznesi me klientët të cilët janë informuar në atë formë.
2. Shoqëria administruese e fondeve dhe agjentët e saj të shitjes duhet të ruajnë të dhëna në lidhje me secilin klient për sa më poshtë:
 - a) Kategorizimit të përcaktuar për klientin, duke përfshirë informacion të mjaftueshëm për të mbështetur këtë kategorizim;
 - b) Vërtetim të dërgimit të klienti të çdo njoftimi të kërkuar sipas dispozitave të këtij Kreu dhe nëse ky njoftim ndryshon nga forma standarde përkatëse, një kopje të njoftimit konkret të dërguar;
 - c) Një kopje të çdo marrëveshjeje të lidhur me klientin.
3. Të dhënat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni regjistrohen në kohën e kategorizimit.

SEKSIONI 2 PËRSHTASHMËRIA

Neni 64

Përshtatshmëria dhe njohja e klientit

Në rastin e dhënies së rekomandimeve për investime ose administrimit të portofoleve individuale, shoqëria administruese, ose agjenti i saj detyrohet të kryejë përshtatshmërinë e klientit sipas përcaktimeve të ligjit "Për tregjet e kapitalit".

SEKSIONI 3 PËRGJEGJËSIA E AGJENTËVE TË SHITJES DHE DHËNIA E INFORMACIONIT NË LIDHJE ME AGJENTËT E SHITJES

Neni 65

Përgjegjësia për statusin dhe kompetencën e agjentëve të shitjes

1. Nëse agjenti i shitjes është shoqëri komisionere, bankë ose shoqëri sigurimi, shoqëria administruese e fondeve është përgjegjëse për të garantuar që agjenti i shitjes të jetë i licencuar nga autoriteti përkatës ose, në rast të degës së një shoqërie komisionere ose institucion tjetër financiar të huaj që të jetë i njohur.
2. Nëse agjenti i shitjes është agjent i lidhur i shoqërisë administruese të fondeve, shoqëria

administruese e fondeve sigurohet që personi fizik apo juridik të jetë i përshtatshëm dhe i duhur dhe ka kualifikimet e nevojshme për të vepruar si agjent shitjesh i sipërmarrjeve të investimeve kolektive në lidhje me publikun e gjerë.

3. Shoqëria administruese e fondeve mund të kufizojë llojin e sipërmarrjeve që një agjent i shitjeve i ofron klientëve të tij:
 - a) Në rast se sipërmarrja ose nënfondi me ofertë publike, janë komplekse ose jo;
 - b) Në rastin e një fondi alternativ investimi me ofertë private, dëshmi se ai u ofrohet vetëm investitorëve profesionistë dhe të kualifikuar.

4. Në çdo rast, shoqëria administruese e fondeve është përgjegjëse sa më poshtë:
 - a) Kërkon nga të gjithë agjentët e shitjes të nënshkruajnë një kontratë që specifikon shërbimet dhe sipërmarrjet ose nënfondet që agjenti i shitjes mund të ofrojë dhe kushtet dhe afatet e kontratës duke përfshirë natyrën dhe vlerën e çdo komisioni ose pagese që shoqëria administruese e fondeve i paguan agjentit të shitjes;
 - b) Sigurohet se agjenti i shitjes ka njohuritë dhe kuptimin e duhur të sipërmarrjeve dhe nënfondeve që i lejohet të shesë, dhe e trajton agjentin në mënyrë të vazhdueshme;
 - c) Sigurohet që agjenti i shitjes të kuptojë plotësisht procesin e shitjes, dhe ka strukturën e duhur administrative për të siguruar përpunimin efikas të shitjeve dhe pagesave dhe që mund të kryejë raportimin në kohë ndaj shoqërisë administruese të fondeve;
 - d) Sigurohet që agjenti i shitjes ka procedura për njohjen e klientit dhe është në gjendje të identifikojë klientët të cilët mund ose nuk kanë njohuri të mjaftueshme ose tolerancë ndaj rrezikut për të qenë në gjendje të blejnë lloje të caktuara të sipërmarrjes ose të nënfondit;
 - e) Sigurohet që agjenti i shitjes informon investitorin në lidhje me statusin dhe shumën e komisionit të paguar për angazhimin e tij në shitjen e aksioneve ose kuotave, të llogaritura si përqindje e komisionit të hyrjes ose komisionit të daljes ose të komisionit vjetor të administrimit duke përfshirë informacionin:
 - i. Nëse agjenti i shitjes është agjent i lidhur dhe si i tillë, ai mund të ofrojë vetëm produktet e shoqërisë administruese të fondeve me të cilën është i lidhur dhe që nuk është i pavarur, si edhe masën e shpërblimit që ai merr nga shoqëria administruese e fondeve për shitjen që bën;
 - ii. Nëse agjenti i shitjes është agjent i klientit, tarifat që aplikohen për ofrimin e rekomandimeve dhe mënyrën se si duhet të paguhet ato.
 - f) Sigurohet që agjenti i shitjes ka procedura për identifikimin e rasteve të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

Neni 66

Kërkesat për individët

1. Punonjësit e një agjenti/distributori të shitjes të aksioneve/kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike duhet të plotësojnë të paktën kushtet e mëposhtme:

- a. Ka përfunduar të paktën studimet e shkollës së mesme;
- b. Ka kryer trajnime dhe është kualifikuar si i përshtatshëm nga shoqëria administruese për shitjen e sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
- c. Nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale;
- d. Nuk ka në proces çështje penale në Prokurori apo Gjykatë;
- e. Nuk ka qenë dënuar për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese e piramidale të huamarrjes, për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Neni 67

Informimi në lidhje me agjentët e shitjes

1. Shoqëria administruese e fondeve mundëson në faqen e saj të internetit dhe i vë në dispozicion çdo investitori potencial një listë të përditësuar të agjentëve të shitjes dhe të agjentëve të lidhur dhe duhet të garantojë që shitjet e sipërmarrjeve të saj të kryhen vetëm përmes agjentëve të kontraktuar të shitjes.
2. Shoqëria administruese e fondeve duhet të verifikojë rregullisht që agjentët e shitjes së saj janë në përputhje të vazhdueshme me afatet dhe kushtet e licencës së shoqërisë administruese të fondeve dhe, nëse jo, duhet të ndërpresë të drejtën e agjentit të shitjes për të shitur sipërmarrjet ose nënfondet e saj dhe njofton menjëherë Autoritetin.

Neni 68

Informacioni që duhet dorëzuar pranë Autoritetit

1. Shoqëria administruese duhet të dorëzojë çdo muaj pranë Autoritetit një listë të përditësuar të agjentëve dhe agjentëve-individë me të cilët janë lidhur kontrata.
2. Lista e referuar në paragrafin 1 të këtij neni do të përfshijë:
 - a) Emrin dhe mbiemrin e personit;
 - b) Adresën e përkohshme/e përhershme;
 - c) Profesionin; dhe
 - ç) Marrëdhëniet mes personit dhe shoqërisë administruese.
3. Në rastin e individëve në një subjekt juridik (agjenti), së bashku me informacion mbi individët të përmendur në paragrafin 2, lista e referuar në paragrafin 1 të këtij neni duhet të përfshijë këto informacione për subjektin juridik (agjenti):
 - a) Emrin e shoqërisë;
 - b) Numrin e regjistrimit të shoqërisë pranë QKR; dhe
 - c) Adresën e zyrave qendrore.
4. Subjekti juridik (agjenti) duhet të ketë një regjistër të individëve-punonjës të autorizuar për të shitur aksionet/kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe do t'ia paraqesë atë Autoritetit me kërkesë të këtij të fundit.

5. Informacioni i paraqitur në përputhje me paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni duhet të jetë i tillë që të provojë vlefshmërinë para Autoritetit të autorizimit për të shitur aksione/kuota në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike.

Neni 69

Monitorimi

1. Autoriteti monitoron aktivitetin e shoqërisë administruese në lidhje me agjentët dhe agjentët-individë që kanë nënshkruar kontratë me këtë shoqëri për shitjen e aksioneve/kuotave në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike.
2. Çdo palë e interesuar ka të drejtën e ankimimit pranë Autoritetit mbi agjentin i cili ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit dhe të kësaj rregulloreje gjatë shitjes së aksioneve/kuotave.
3. Ankimimet e paraqitura në Autoritet do të dorëzohen me shkrim. Autoriteti nuk do të marrë në konsideratë ankimimet e panënshkruara dhe anonime.
4. Në rastin kur Autoriteti, pas marrjes së një ankimimi të nënshkruar dhe joanonim, përcakton se një agjent ka shkelur dispozitat e Ligjit dhe të kësaj rregulloreje, gjatë shitjes së aksioneve/kuotave, informon për rezultatet shoqërinë administruese që ka nënshkruar një kontratë me këtë individ.

KREU VI

REGJISTRIMI I PRONËSISË SË AKSIONEVE OSE KUOTAVE

Neni 70

Regjistrimi dhe transferimi i pronësisë së aksioneve ose kuotave

1. Shoqëria administruese e fondit të investimeve me ofertë publike është personi përgjegjës për krijimin dhe mbajtjen e regjistrimit të kuotave të fondit, depozitari i fondit mban njëkohësisht regjistrin e kuotave të fondit, si dhe verifikon dhe kontrollon që çdo veprim i shoqërisë administruese, në lidhje me këtë regjistër, është në përputhje me kërkesat ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
2. Në rast se fondi i investimeve me ofertë publike është i listuar në një treg të rregulluar, depozitari mund të delegojë mbajtjen e regjistrimit të një regjistruar i licencuar, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon fushën e tregjeve të kapitalit, ose depozitarin qendror të titujve, siç kërkohet nga rregullat e këtij tregu.
3. Mbajtësit e kuotave ose aksionarët ose përfaqësuesit e tyre të noterizuar kanë të drejtë të kërkojnë një certifikatë në formë të prekshme që vërteton pronësinë e numrit të aksioneve ose kuotave të çdo klase të zotëruar në emër të tyre në regjistrin e sipërmarrjes ose nënfondit për të cilat mund të bëhet një pagesë e arsyeshme. Kjo

certifikatë i jepet mbajtësit të kuotave nga shoqëria administruese.

4. Shoqëria administruese duhet:
 - a) Të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të ndryshuar regjistrin pas marrjes së njoftimit me shkrim për ndryshimin e emrit ose adresës së çdo aksionari ose mbajtësi kuotash;
 - b) Në lidhje me një ndryshim të emrit sipas shkronjës a) të kësaj pike, kur është lëshuar një certifikatë, ose të miratojë certifikatën ekzistuese ose të lëshojë një të re;
 - c) T'u mundësojë pa pagesë çdo aksionari ose mbajtësi kuotash ose përfaqësuesit të tij të autorizuar një kopje të hyrjeve në regjistër lidhur me këtë aksionar ose mbajtësi kuotash në bazë të kërkesës së tyre;
 - d) Të njoftojë njëkohësisht Depozitarin për çdo ndryshim të regjistrit.

Neni 71

Transferimi i pronësisë

1. Çdo pjesëmarrës në fondin e investimeve me ofertë publike ka të drejtë t'i transferojë kuotat e mbajtura në regjistër nëpërmjet një akti transferimi të pronësisë në çfarëdo formë që miratohet nga shoqëria administruese si person përgjegjës për regjistrin, nëse lejohet nga akti themelues i sipërmarrjes dhe legjislacioni i fushës në fuqi.
2. Çdo akt transferimi në lidhje me kuotat e një fondi të investimeve me ofertë publike nënshkruhet nga ose në emër të mbajtësit të kuotave që transferon kuotat (ose, në rastin e subjektit juridik, duhet të mbajë vulën e këtij subjekti ose të nënshkruhet nga një ose më shumë nëpunës të subjektit që kanë autorizimin përkatës për nënshkrim) dhe transferuesi trajtohet si pjesëmarrës deri në momentin kur emri i marrësit të jetë regjistruar në regjistër.
3. Çdo akt transferimi (me vulën përkatëse, sipas rastit) depozitohet për regjistrim pranë personit përgjegjës për regjistrin, shoqëruar me:
 - a) Dokumentet e nevojshme që kërkon legjislacioni; dhe
 - b) Çdo dëshmi tjetër që kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga shoqëria administruese, e cila ia dërgon depozitarit të gjithë dokumentacionin.

KREU VII

FUNKSIONIMI I DEPOZITARIT NË LIDHJE ME SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE

SEKSION 1

FUNKSIONIMI I DEPOZITARIT

Neni 72

Kontrolli nga depozitari i aktiveve të sipërmarrjes ose nënfondit

1. Depozitari është përgjegjës për ruajtjen e të gjithë pasurisë së sipërmarrjes ose të nënfondit që i është besuar dhe duhet të kryejë sa më poshtë:
 - a) Të ndërmarrë të gjitha hapat dhe të plotësojë të gjitha dokumentet e nevojshme për të siguruar përfundimin e duhur të transaksioneve të lidhura për llogari të sipërmarrjes ose të nënfondit;
 - b) Të sigurohet, sa më shpejt të jetë e mundur, që forma e regjistruar e pronës së sipërmarrjes ose nënfondit, të regjistrohet në emër dhe për llogari të sipërmarrjes ose nënfondit;
 - c) Të marrë në kujdestari dhe/ose të mbajë evidencat e dokumenteve të titullit të pasurisë për aktivet e sipërmarrjes ose të nënfondeve, përveçse rastit të transaksioneve në *derivativë* ose në kontrata standard të së ardhmes; dhe
 - d) Të sigurojë që çdo transaksion në *derivativë* ose në kontrata standard të së ardhmes të lidhet në mënyrë që të garantojë që çdo përfitim të merret nga depozitari.
2. Depozitari është përgjegjës për mbledhjen e të ardhurave (dividendët mbi aksionet, interesat mbi obligacionet ose depozitat) që duhet të paguhet për llogarinë e sipërmarrjes ose të nënfondit.

Neni 73

Veprimet korporative

Depozitari informon menjëherë shoqërinë administruese të fondeve për çdo veprim korporativ që lind në lidhje me zotërimet në portofolin e një sipërmarrjeje ose nënfondi dhe ndërmerr të gjitha hapat e nevojshme për të garantuar që udhëzimet që i janë dhënë nga shoqëria administruese e fondeve për ushtrimin e të drejtave që lidhen me pronësinë e aktiveve të sipërmarrjes ose të nënfondit, të zbatohen.

Neni 74

Ruajtja e të dhënave të sipërmarrjeve dhe nën-fondeve nga depozitari

1. Depozitari, në lidhje me secilën sipërmarrje ose nënfond të cilit i ofron shërbime depozitare, mban të dhëna të cilat janë të nevojshme për sa më poshtë:
 - a) T'i mundësojnë që ai të përmbushë detyrat e tij sipas Ligjit dhe rregulloreve në fuqi; dhe
 - b) Të tregojë se i ka përmbushur këto detyra në pajtim me Ligjin dhe Rregulloret në fuqi.
2. Këto të dhëna mbahen për periudhën e kërkuar nga legjislacioni i zbatueshëm për ruajtjen dhe arshivimin e dokumentacionit.

3. Këto të dhëna duhet të vihen në dispozicion të Autoritetit sipas kërkesës.
4. Të dhënat e sipërmarrjes dhe nënfondit duhet të mbahen në mënyrë të tillë që Autoriteti të jetë në gjendje t'i aksesojë ato lehtësisht dhe të verifikojë lehtësisht çdo korrigjim, ndryshim dhe përmbajtjen e këtyre të dhënave para ndodhjes së këtyre ndryshimeve, si edhe duhet të jetë e pamundur që të dhënat të manipulohen ose të ndryshohen.

Neni 75
Rakordimi i të dhënave

1. Depozitari rakordon të dhënat e veta të kuotave në qarkullim të fondit të investimit me pjesëmarrje të hapur ose me intervale dhe të dhënat e aktiveve dhe pasiveve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të licencuara me të dhënat e shoqërisë administruese të fondit çdo ditë.
2. Mos rakordimi i të dhënave sipas pikës 1 këtij neni duhet të raportohet në Autoritet nga depozitari në mënyrë elektronike jo më vonë se dita e njëjtë e punës.

KREU VIII
DISPOZITA TË TJERA

Neni 76
Shfuqizimi

Rregulloret nr. 69, datë 26.05.2011 “Për autorizimin e individëve për shitjen e kuotave/aksioneve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike”, nr. 77, datë 29.06.2011 “Mbi përcaktimin e vlerës së aseteve të sipërmarrjeve të investimit kolektiv dhe llogaritjen e vlerës neto të aseteve të tyre për kuotë ose për aksion”, nr. 130, datë 06.10.2011 “Për regjistrin e investitorëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”, nr. 131, datë 06.10.2011 “Mbi kodin e sjelljes të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”, nr. 57, datë 29.03.2018 “Mbi transaksionet me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar” shfuqizohen.

Neni 77
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj.

SHTOJCA 1

1. A është kryer transaksioni në bursë/treg të organizuar sipas kushteve të pikës 3/a të nenit 20?
Nëse po, duhet konfirmimi i marrëveshjes të kryer në bursë.
2. Është kryer transaksioni në një treg të rregulluar sipas kushteve të pikës 3/b të nenit 20?
Nëse po, dokumentacioni duhet të përfshijë:
 - a. Vendim nga Shoqëria administruese për qëllimin e kryerjes së transaksionit.
 - b. Në rast të një tregu aktiv, një *screenshot* (p.sh. Bloomberg All quotes për letrën me vlerë e cila është tregtuar, verifikohet nëse çmimi ka qenë brenda “range bid/ask” të tregut, krahasohet dhe me “*mid price*”).
 - c. Në rast të një tregu të rregulluar por jo aktiv (kontaktet dhe bisedat e dokumentuara me të paktën tre broker/dealer ku është kërkuar ofertë për kryerjen e transaksionit “*bid/ask*”).
3. A është kryer transaksioni sipas kushteve të pikës 3/c të nenit 20?
 - Nëse është kryer me një broker/dealer ndërkombëtar, “*screenshot*” të të gjitha kuotimeve për atë instrument.
 - Nëse është kryer me një broker lokal, “*print screen*” të kuotimeve të brokerit në momentin e kryerjes së transaksionit, si dhe bisedat e dokumentuara me brokera të tjerë (krahasohet nëse çmimi ka deviacione nga “*bid/ask range mesatar*”).
4. A është kryer transaksioni në një treg të rregulluar por që nuk përfshihet në pikën 3/c të nenit 20?
 - Nëse po, Deklaratën e Shoqërisë administruese në lidhje me faktin që transaksioni ka qenë “*arms length*”. Si dhe bisedat e dokumentuara me të paktën tre broker/dealera ku është marrë ofertë për kryerjen e transaksionit (bid-ask). Në qoftë se nuk ka oferta, duhet argumentim i detajuar nga shoqëria administruese, se përse konsiderohet “*arms length*” transaksioni, duke përfshirë kurbën e *yieldit* të instrumentit me interpolim, por duke eliminuar pikat e kurbës që kanë diferencë të dukshme me pikat e tjera.
5. A është kryer transaksioni sipas kushteve të pikës 3/f të nenit 20?
Nëse po, dokumentacion mbështetës që vërteton se emetimi ka qenë për herë të parë.

SHTOJCA 2

Lista e bursave aktive dhe indekseve

Për qëllimin e kësaj rregulloreje, titujt e tregtuar në bursat, platformat tregtare shumëpalëshe dhe indekset e mëposhtme, do të konsiderohen si letra me vlerë të tregtuara në tregun aktiv.

1. Tregjet aktive

Bursa Australiane

BME - Bursa Spanjolle

Bursa e Frankfurtit

Bursa e Hong Kongut

Bursa e Italisë

Bursa e Koresë

Bursa e Londrës

NASDAQ

Bursa e Nju Jorkut

Euronext

Bursa e Zelandës së Re

Bursat OMX Nordic

Bursa SIX Zviceran

Bursa e Shangait

Bursa Shenzhen

Bursa e Tokios

Bursa e Torontos

2. Indekset

AEX-Index

Amex

Indeksi CAC 40

CAC Tjera 20

Deutsche Boerse AG German Stock Index DAX- Indeksi i Aksioneve në Gjermani
DAX

Doë Jones & Company

EURO STOXX 50 Çmimi EUR

Indeksi

Indeksi i FTSE 100

Indeksi i FTSE MIB

Indeksi FTSE MID 250

Indeksi Hong Kong i Hang Seng

Indeksi IBEX 35

JPX400

Indeksi Lux - Bursa e Luksemburgut

MICEX

MSCI

Nikkei 225

Indeksi OBX

Indeksi OMX Stockholm 30

RTSI

Indekset Russell

SBF 250

Standard & Poor's

S & P / ASX 200

Indeksi i Tregut të Zvicrës

Topix